



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:234864

Datë: 29.11.2023

Numri i dokumentit: 04981765

**PKR.nr.220/22**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA,** Kryetari i trupit gjykues Sami Sharaxhiu, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Tringa Zhuti, në çështjen penale ndaj të pandehurit Sh.Z., nga fshati B., Komuna GJ., i akuzuar për veprë penale *posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge* nga neni 269 par.1 lidhur me nenin 275 par.1 pika 1.8 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.291/22, të datës 11.11.2022 dhe veprë penale *posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge* nga neni 269 par.1 lidhur me nenin 275 par.1 pika 1.8 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.83/23, të datës 15.11.2023, konform nenit 34 par.7 dhe 8 të KPPRK-së, të bashkuara sipas Aktvendimit PKR.nr.220/22, të datës 23.11.2023, pas seancës së shqyrtimit fillestar të datës 22.11.2023 të mbajtur në prezencën e prokurorit të shtetit Valbona Disha Haxhosaj, të pandehurit Sh.Z. si dhe mbrojtësit të tij avokatit Valon Demiraj, nga Istogu, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli ndërsa, me datë 29.11.2023 përpiloi këtë :

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri:**

**SH.Z.**, i lindur me datë ..., në fshatin B., Komuna GJ., ku edhe jeton, nga i ati N. dhe nëna E., e gjinisë M., i pa punë, i pamartuar, ka të kryer 7 klasë të shkollës fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar me numër personal ....., i nacionalitetit rom, shtetas i Republikës së Kosovës, **gjendet në vuajtje të dënimit për një veprë tjetër penale.**

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak se :**

- I. Më datë 26.08.2022, rreth orës 12:00, në Qendrën Korrektuese – D.pikërisht në krahun .. dhoma .., pa autorizim ka poseduar substancë narkotike në brendi të Institucionit Korrektues, në atë mënyrë që gjatë kontrollit nga oficerët korrektues të dënuarit Sh.në komodën e plastikës i gjejnë një sasi të vogël të substancës së dyshuar narkotike e cila pas ekzaminimit ka rezultuar të jetë e llojit marihuanë në peshë prej 0.5 gram.

- me çka ka kryer veprën penale *posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge* nga neni 269 par.1 e lidhur me nenin 275 par.1 pika 1.8 të KPRK-së.

II. Me datë 30.07.2023, rreth orës 19:45, në Qendrën Korrektuese në D., Komuna Istog, në pavijonin ..., krahu ..., dhoma nr..., pa autorizim posedon substancë narkotike të llojit marihuanë, në atë mënyrë që, i pandehuri përderisa gjendet në vuajtje të dënimit për një veprë tjetër penale në Institucionin Korrektues si më lartë, posedon substancën narkotike të llojit marihuanë, me peshë 0.034 miligram, e cila substancë nga oficerët e Qendrës Korrektuese, gjatë kontrollit i gjendet të njëjtit në xhepin e pantallonave, ku pas ekzaminimit ka rezultuar si e llojit dhe e peshës si më lartë e cila edhe është konfiskuar nga ana e policisë

- me çka ka kryer veprën penale *posedimi i paautorizuar i substancave narkotike, substancave psikotrope ose analoge* nga neni 269 par.1 e lidhur me nenin 275 par.1 nënpar. 1.8 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 76 par.1 dhe 2 pika 2.1, 2.4 dhe 2.5, neni 269 par.1 e lidhur me nenin 275 par.1 pika 1.8 të KPRK-së si dhe nenet 358, 359, 360, 364 të KPRK-së, të pandehurit Sh.Z. **I PËRCAKTON:**

- I. Për veprën penale si në dispozitivin e parë, DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej një (1) vit e tre (3) muaj dhe DËNIM ME GJOBË në shumë prej dyqind (200) euro.PP
- II. Për veprën penale si në dispozitivin e dytë, DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej një (1) vit e tre (3) muaj dhe DËNIM ME GJOBË në shumë prej dyqind (200) euro.

Konform nenit 76 të KPRK-së të pandehurit Sh.Z. **I SHQIPTON :**

**DËNIM UNIK ME BURGIM në kohëzgjatje prej dy (2) vjet e tre (3) muaj**, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe

**DËNIM UNIK ME GJOBË në shumë prej katërqind (400) euro**, të cilin dënim me gjobë është i obliguar që ta paguaj në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, e po qe se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burg ku një ditë burgu do t'i llogarite në shumë prej njëzet (20) euro.

**OBLIGOHET** i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej njëzetepesë (25) euro si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej pesëdhjetë (50) euro, e të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Ndaj të pandehurit Sh.Z. në kuptim të nenit 269 par.3 të KPRK-së, shqiptohet:

**DËNIMI PLOTËSUES – MARRJA E SENDEVE/KONFISKIMI I**

- Substancës narkotike e llojit marihuanë në peshë prej 0.5 gram të evidentuar në Listën e dëshmime të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Policisë – Pejë – Njësia e Forenzikës, me numër të rastit ....., të datës 26.08.2022 dhe
- Substancës narkotike e llojit marihuanë në peshë prej 0.034 miligram të evidentuar në Listën e dëshmime të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Policisë – Pejë– Njësia e Forenzikës, me numër të rastit ....., të datës 30.07.2023.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, kundër të pandehurit .., nga Ferizaj, me banim në rrugën “B. dhe G S” pn., ka ngritur Aktakuzën PP/I.nr.291/22, të datës 11.11.2023, për shkak të veprës penale *posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge* nga neni 269 par.1 e lidhur me nenin 275 par.1 pika 1.8 të KPRK-së si dhe Aktakuzën PP/I.nr.83/23, të datës 15.11.2023, për vepër penale *posedimi i paautorizuar i substancave narkotike, substancave psikotrope ose analoge* nga neni 269 par.1 e lidhur me nenin 275 par.1 nënpar. 1.8 të KPRK-së.

Me datë 22.11.2023, gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur seancën fillestare në prezencën e prokurorit të shtetit Valbona Disha Haxhosaj, të pandehurit Sh.Z. si dhe mbrojtësit të tij avokatit Valon Demiraj, nga Istogu.

Në fillim të seancës prokurorja e shtetit Valbona Disha Haxhosaj, meqë është vënë në dijeni se për të pandehurin Sh.Z. përveç se është ngritur Aktakuza PP/I.nr.291/22, e datës 11.11.2022, në ndërkohë me datë 15.11.2023, në Gjykatë është sjellë edhe Aktakuza PP/I.nr.83/23 dhe në të dy aktakuzat i pandehuri akuzohet për vepër të njëjtë penale andaj, konform nenit 34 par.8 të KPPRK-së i ka propozuar gjykatës që me qëllim të ekonomizimit të procedurës të bëjë bashkimin e procedurës dhe ndaj të pandehurit të merret një aktgjykim. Mbrojtësi i të pandehurit Sh.Z., avokati Valon Demiraj dhe i pandehuri Shqyeri Z. nuk e kundërshtuan propozimin e prokurores së shtetit për bashkim të procedurave.

Me Aktvendimin PKR.nr.220/22, gjykata duke vepruar konform nenit 34 par.7 të KPPRK-së, ka aprovuar propozimin e prokurorit të shtetit dhe ka marr Aktvendim për bashkimin e procedurës penale ndaj të pandehurit Shqyeri Z. sipas numrit të lëndës PKR.nr.220/22 me procedurën penale PKR.nr.96/23 dhe lënda do të udhëhiqet nën numrin PKR.nr.220/22.

Pas leximit të Aktakuzës PP/I.nr.291/22, të datës 11.11.2023 dhe Aktakuzës PP/I.nr.83/23, të datës 15.11.2023, nga ana e Prokurorit të Shtetit, në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se i pandehuri i ka kuptuar aktakuzat që i vihen në barrë dhe të njëjtit ia ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë. Në këtë rast gjykata e ka udhëzuar të pandehurin për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë me ç’rast i pandehuri Sh.Z. deklaroi se i ka kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimin të fajësisë të cilat i janë shpjeguar nga ana e gjykatës dhe se e pranon fajësinë në baza vullnetare për veprat penale *posedimi i paautorizuar i narkotikeve substancave psikotrope dhe analoge* nga neni 269 par.1 lidhur me nenin 275 par.1 pika 1.8. të KPRK-së, sipas Aktakuzës PP/I.nr.291/22, të datës 11.11.2022 dhe për vepër penale *posedimi i paautorizuar i narkotikeve substancave psikotrope dhe analoge* nga neni 269 par.1. lidhur me nenin 275 par.1.pika 1.8. të KPRK-së, sipas Aktakuzës PP/I.nr. 83/23, të datës 15.11.2023.

Prokurori e shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për të dyja veprat penale meqenëse ky pranim korrespondon edhe me provat në bazë të cilave janë ngritur që të dy aktakuzat ashtu që i ka propozuar gjykatës që ta aprovoi pranimin e fajësisë e meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë në tërësi mbetet pranë aktakuzave, përshkrimit faktik dhe juridik të veprave penale dhe i propozoi gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtor, ta dënoi sipas ligjit si dhe ta obligoi në kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe që substancat narkotike të cilat janë sekuestruar të njëjtat të konfiskohen dhe të lëshohet urdhri për shkatërrim. Me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, i propozoi gjykatës që si rrethanë rënduese të vlerësoi shkallën e lartë të dashjes, të kaluarën kriminale të pandehurit e i cili është shpallur fajtor dhe dënuar me tetë (8) aktgjykime të plotfuqishme, kurse si rrethanë lehtësuese ta vlerësoi pranimin e fajësinë.

Mbrojtësi i të pandehurit Sh.Z., avokati Valon Demiraj deklaroi se pajtohet me pranimin fajësisë nga ana e të pandehurit për të dyja veprat penale pasi i njëjti është bërë në mënyrë të plotë dhe të vullnetshme dhe pas konsultimit me të si mbrojtës. I njëjti deklaroi se heqin dorë nga seanca për caktimin e dënimit pas pranimit të fajësisë apo aktgjykimit dënues konform nenit 356 të KPPK-së dhe lidhur me dënimin i propozoi gjykatës që me rastin e vendosjes së lartësisë së dënimit ndaj të pandehurit të zbatoi rrethana lehtësuese ashtu që si rrethanë lehtësuese të marrë pranimin e fajësisë në të gjitha stadet e procedurës si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprat të tjera të ngjashme.

I pandehuri Sh.Z., lidhur me dënimin deklaroi se në tërësi pajtohet me deklarinimin e mbrojtësit të tij .

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hedhje të aktakuzës konform nenit 248 të KPPRK-së dhe se janë plotësuar kushtet nga neni 241 dhe 242 par.2 pika 2.1 deri 2.4 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave por, gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjykata duke u gjendur para këtyre fakteve siç janë, pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, si dhe duke pasur parasysh provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: Raporti i policit R.M me numër të rastit ..., i datës 29.08.2022, Raporti për bastisje të pavijonit nr.. krahu ., i datës 26.08.2022, Raporti i analizës se narkotikeve NarTest, i datës 29.08.2022, fotot e substancës narkotike të bashkëngjitura në Aktakuzën PP/I.nr.291/22 si dhe Raporti Policor i Policisë së Kosovës - Njësiti i DHTN Pejë, i datës 11.09.2023, Raporti i zyrtarit policor H L #.., i datës 19.09.2023, Raporti i Qendrës Korrektuese – D., i datës 04.08.2023, Raporti Iniciues Disiplinor i Qendrës Korrektuese D., me nr. rendor ../.., i datës 30.07.2023, Një (1) fotografi ku shihet substanca narkotike, Procesverbali i marrjes në pyetje nga ana e policisë për të pandehurin Sh.Z. me datë 18.09.2023 si dhe deklarata e dhënë në Prokurori, me datë 03.11.2023, Raporti nga njësia e DHTN- Pejë mbi analizën e narkotikëve, Raporti i NarTest-it me katër (4) fotografi ku shihet substanca narkotike e llojit “*Marihuanë*” si dëshmi e evidentuar si D#1, Informacionet për të dyshuarin si dhe e kaluara kriminale e tij e nxjerrë nga data-baza policore dhe Raporti i DR. Pejë - Njësia e Forenzikës mbi listën e dëshmive të bashkëngjitura Aktakuzës PP/I.nr.83/3, si dhe shkresat tjera të lëndës, erdhi në përfundim se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale të përshkruar si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Duke vendosur lidhur me vendimin mbi dënim konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin e dënimit dhe nga rrethanat lehtësuese për të pandehurin gjeti se i pandehuri e ka pranuar fajësinë në seancë fillestare ndërkaq, nga rrethanat rënduese për të pandehurin gjykata gjeti të kaluarën e tij kriminale dhe atë faktin se i njëjti është i dënuar me tetë (8) aktgjykime të formës së prerë për vepra të ndryshme penale.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të pandehurin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë së tij penale dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale, konform nenit 38 të KPRK-së.

Duke u bazuar në nenin 449 të KPPRK-së e obligoi të pandehurin në pagimin e shpenzimeve të paushallit gjyqësor.

Konform nenit 36 par.1, 2, 3 nënpar. 3.2 të Ligjit për Kompensim të Viktimave të Krimit e obligoi të pandehurin që të paguaj taksën për kompensimin e viktimave të krimit.

Konform nenit 269 par.3 të KPRK-së, të pandehurit ju konfiskua substanca narkotike e llojit marihuanë në peshë prej 0.5 gram,e evidentuar në Listën e dëshmime të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Policisë – Pejë – Njësia e Forenzikës, me numër të rastit ... – .. - ..., të datës 26.08.2022 dhe substanca narkotike e llojit marihuanë, në peshë prej 0.034 miligram, e evidentuar në Listën e dëshmime të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Policisë – Pejë– Njësia e Forenzikës, me numër të rastit ..., e datës 30.07.2023.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 364 të KPPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA  
PKR.nr.220/22, me datë 29.11.2023**

**Bashkëpunëtorja Profesionale  
Tringa Zhuti**

**Kryetari i Trupit Gjyqësor  
Sami Sharaxhiu**

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.